



Festivali i ëmbëlsirave

Rregullat e aplikimit për periudhën Korrik 2016

QËLLIMI

Festivali i ëmbëlsirave, ideuar dhe organizuar nga Komuna e Prishtinës ka për synim mbështetjen e bizneseve të vogla me ide kreative. Këto të fundit do të kenë rastin të bëjnë shitjen e produkteve ushqimore (ëmbëlsirave dhe pijeve freskuese), në periudhë prej 7 ditë në 12 shtëpiza të drurit të cilat do të vendosen në sheshin “Zahir Pajaziti”.

RREGULLAT E FESTIVALIT TË ËMBËLSIRAVE

1) Vendi dhe orari i punës

Hapja e Festivalit të ëmbëlsirave do të bëhet me datë 4 korrik 2016 në sheshin “Zahir Pajaziti” ku do të qëndrojë hapur deri me 11 korrik 2016. Gjatë këtyre 7 ditëve bizneset e përzgjedhura për shtëpiza lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës 09:00 deri në orën 23:00. Asnjë shitje nuk do të lejohet para orës 09:00 si dhe pas orës 23:00.

2) Kriteret e aplikimit

Përzgjedhja e bizneseve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në Festivalin e ëmbëlsirave do të bëhet nga një komision i posaqëm formuar në Drejtorinë për Shërbime Publike pranë Komunës së Prishtinës. Pasi numri i shtëpizave do të jetë i limituar është bërë aplikimi i kriterëve si më poshtë në mënyrë që selektimi të jetë sa më adekuat:

- Bizneset duhet të aplikojnë me produkte të ëmbëlsirave dhe pije freskuese
- Bizneset duhet të aplikojnë me varietet të ëmbëlsirave , së paku 5 lloje;
- Bizneset duhet të kenë dëshmi të ushtrimit të veprimtarisë specifike për të cilën do të aplikojnë;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë pajisur me mjete/ vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në Festivalin e ëmbëlsirave;

- Bizneset të cilat dorëzojnë formën e aplikimit të parat që nga data e njoftimit, do të trajtohen me prioritet;
- Bizneset të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore do të trajtohen me prioritet.

3) Tarifa e shfrytëzimit të shtëpizës

Tarifat për shfrytëzimin e shtëpizave të tregut të fundvitit janë përcaktuar duke u bazuar në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike, ku pagesa aplikohet në bazë të hapësirës publike të cilën e zë një shtëpizë. Pra, bizneset e selektuara do të jenë të obliguara të paguajnë paraprakisht shumën prej **10.00 Euro për m²** për periudhë një javore të shfrytëzimit të shtëpizës në hapësirë publike.

4) Kodi mirësjelles dhe obligimet shtesë

Të gjitha bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfillt në mes tyre. Në mënyrë që ky bashkëpunim të jetësohet sa më mire, komuna e Prishtinës gjatë 1 jave të Festivalit të ëmbëlsirave ndalon rreptësisht aktet si më poshtë. Nëse bëhet kryerja e tyre sanksionimi do të jetë marrja e lejës për shtëpizë si dhe në asnjë mënyrë nuk do të bëhet kthimi i mjeteve të paguara për shfrytëzim të saj.

- Kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme mbrenda zonave të zhvillimit të festivalit;
- Abuzimin verbal ose fizik të personave të cilët përfaqësojnë bizneset shitëse konkurruese, si dhe të blerësve apo qytetarëve të tjerë kalimtarë;
- Shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërin prej shtëpizave;
- Obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që pas përfundimit të orarit të punës ta pastrojnë shtëpizën e tyre dhe hapësirën rreth saj.
- Bizneset e përzgjedhura duhet ta dekorojnë shtëpizën në bazë të dizajnit të propozuar nga Komuna, pasi që synohet të krijohet një pamje e njejtë.

5) Vendi i dorëzimit të aplikacionit

Komuna e Prishtinës (ndërtesa e re) në lagjen Arbëria
Drejtoria e Shërbimeve Publike, kati i 2-të